

qershor 2010

gap

# monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

- Nis procesi për privatizimin e PTK-së
- Qeveria miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë
- Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010
- Miratohet edhe një herë Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011-2013

Qeveria e Republikës së Kosovës ka lënë mbrapa 6 mujorin e parë të qeverisjes së saj për vitin 2010. Gjatë muajit qershor janë mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe janë marrë 30 vendime. Numri i mbledhjeve që nga fillimi i këtij mandati qeverisës ka arritur në 131. Edhe në këtë muaj, Qeveria e Kosovës ka vazhduar me miratimin e projektligjeve nga Strategjia Legjislative 2010. Mirëpo, procesi i miratimit të projektligjeve nuk është duke shkuar sipas afateve të parapara me këtë strategji. Me ndryshimet e bëra gjatë muajit qershor, SL'10 tani përmban 128 projektligje. Tani që ka kaluar gjysma e vitit, Qeveria ka miratuar vetëm 34 prej tyre apo 27% të strategjisë. Për shkak të marrëveshjes së arritur në mes të Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së, Qeveria është obliguar që të ndryshojë dhe procedojë në mënyrë të përshejtuar për në Kuvend projektligjet më të rëndësishme nga fusha e ekonomisë. Përveç projektligjeve, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe një herë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013, edhe pse të njëjtën e ka miratuar edhe një muaj më parë.

Padyshim një nga vendimet që më së shumti ka ngjallë debat është vendimi për privatizimin e PTK. Në këtë numër të GAP Monitor keni mundësi të lexoni pjesë nga Strategjia e Qeverisë së Kosovës për Privatizimin e PTK-së, dokument i cili i është dërguar Kuvendit për miratim. Po këtë muaj është miratuar edhe Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2010, i cili ka mënjeluar disa dobësi të PVPE të vitit të kaluar. Qeveria ka miratuar edhe Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, e cila identifikon sfidat e sigurisë për Kosovën dhe parasheh hapat që nevojiten për zgjidhjen e tyre. Për sfidat e sigurisë, dhe për vendimet tjera që Qeveria ka marrë gjatë muajit qershor 2010, ju ftojmë të lexoni në brendi të GAP Monitor.

## Përmbajtja:

1. Nis procesi për privatizimin e PTK-së
2. Qeveria miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë
3. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010
4. Miratohet edhe një herë Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011-2013
5. Miratohet PVPE 2010
6. Kosova me strategji të sigurisë
7. Strategjia Legjislative 2010 tani përmban 128 projektligje
8. Qeveria pronëson pronat publike dhe shpronëson pronat private për hir të autostradës
9. Qeveria shkel Rregulloren për Ligjin Themelor të Punës
10. Qeveria miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat
11. Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës
12. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
13. Qeveria miraton Strategjinë për Pronësi Intelektuale
14. Miratohet Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës
15. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Politika Tregtare
16. Miratohet projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës
17. Miratohet Projektligji për Ujërat e Kosovës
18. Miratohet Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
19. Qeveria miraton Strategjinë për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë
20. Qeveria ndanë mjete financiare për fshatin Debëllde, për Lidhjen e Shkrimtarëve dhe për gërmimin e një varreze masive
21. Ndahen 250.000 euro për invalidët e luftës së UÇK-së për rehabilitim në bregdetin shqiptar
22. Qeveria ndanë 300.000 euro për ri-integrimin e personave të riatdhesuar
23. Sigurohet hapësira për ndërtim të 'Shkollës së Talenteve' dhe kampusit të AUK

## Nis procesi për privatizimin e PTK-së

*Komisioni ndërministror i ka propozuar Qeverisë dy opsione për privatizimin e postës: a) 75% të aksioneve apo b) 100% të aksioneve të PTK-së. Qeveria ka vendosur për opsionin e parë, që nënkupton vetëm privatizimin e Telekomit dhe Valës, por jo edhe të Postës.*

Kritikat e shumta nga instancat politike dhe financiare ndërkombëtare rreth keq menaxhimit të ndërmarrjeve publike si dhe mos efikasitetit të ofrimit të shërbimeve nga këto të fundit të cilat po kontribuojnë direkt edhe në ngritjen e nivelit të korrupsionit, kanë shtyrë Qeverinë e Kosovës të mendojë seriozisht në zgjidhjen e këtij problemi duke shmangur ndikimin politik në ekonominë e brishtë të Kosovës dhe duke i hapur rrugën investitorëve potencial privat që të udhëheqin me të. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës konsideron që shitja e asetëve të PTK-së do t'i hapë rrugën liberalizimit të mëtutjeshëm të ekonomisë së Kosovës ku do të behej e mundur thithja e kapitalit të shumë kompanive prestigjioze. Tashmë, Qeveria ka ndarë mendjen rreth kësaj çështjeje dhe pritet që PTK-ja të privatizohet deri në fund të këtij viti. Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të rregullt të 130-të, të mbajtur më 16 qershor 2010, vendosi t'i ofrojë për tenderim dhe shitje 75% të aksioneve të PTK-së. Po ashtu, në këtë vendim është themeluar Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së në të cilin do të bëjnë pjesë Ministri i MEF-it, MTI-së, MTPT-së, MPMS-së dhe MAPL-së. Detyra e këtij komisioni do të jetë adresimi dhe negociimi në mënyrë të përgjegjshme-sociale të kërkesave të punëtorëve të PTK-së gjatë procesit të privatizimit si dhe përfundimin e negociatave me investitorin potencial.

Vendimi rreth privatizimit të kësaj ndërmarrjeje daton qysh nga data 13 tetor 2008 (Vendimi nr. 02/41) ku vendoset të ngrihet një Komision Ndërministror për të analizuar dhe për të bërë rekomandime për pjesëmarrjen e sektorit privat në PTK. Ky komision kishte për detyrë të hartonte strategjinë për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje përmes angazhimit të konsulentëve privat të jashtëm në lidhje me shërbimet këshillëdhënëse për Transaksion.

Kjo kompani konsulente kishte filluar punën në nëntor 2009 dhe deri më tani kur edhe i ka ofruar Komisionit Strategjinë për Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në PTK. Strategjia e paraqitur nga ky

Komision i hartuar nga kjo kompani këshilluese e transaksionit ngërthen në vete analizën, ekzaminimet dhe vlerësimin e tregut për privatizimin e PTK-së. Aty shtjellohen disa probleme që kanë filluar në lidhje me uljen e nivelit të profitabilitetit të PTK-së pas hyrjes së operatorit privat të telefonisë mobile IPKO, mundësitë e kufizuara aktuale të PTK-së në ofrimin e shërbimeve të mjaftueshme për konsumatorët, krahasimi i tregut të Kosovës me tregjet tjera të Evropës Lindore dhe Juglindore, mos futja në treg të operatorit të tretë të telefonisë mobile në Kosovë etj.

Në saje të këtyre vlerësimeve ky komision ka paraqitur në këtë strategji dy opsione për privatizimin e PTK-së. Opsioni i parë është shitja e 67%-100% të aksioneve si dhe opsioni i dytë është ai i shitjes së 100% të aksioneve. Në këtë kontekst është rekomanduar që Posta si njësi në vete të privatizohet së bashku me Telekomin dhe Valën për shkak se një ndarje e tillë para privatizimit vetëm se do të vononte këtë proces. Megjithatë, mundësia do të lihet pas privatizimit që Posta t'i rikthehet në pronësi Qeverisë së Kosovës. Pas ofrimit të opsioneve për formën e shitjes së aksioneve, ky komision i rekomandon qeverisë që të shiten 67%-100% të aksioneve, gjegjësisht të rrumbullakohet në 75% të aksioneve (opsioni i parë) që do t'i mundësonte Qeverisë të ketë disa të drejta bllokuese në bordin e menaxhimit (që kryesisht do të ndërlidhej me ristrukturimin e afarizmit të postës) si dhe rekomandimi i dytë është që PTK të shitet "si është" përfshirë biznesin e postës me një obligim të investitorit për të ndarë Postën në një subjekt të veçantë juridik pas privatizimit. Ky komision, gjithashtu ka paraqitur dhe planin kohor të implementimit të projektit të privatizimit të PTK-së ku parashihet që ky projekt të implementohet i tëri në shkurt të 2011, pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë dhe investitorit potencial që pritet të bëhet në javën e parë të dhjetorit 2010. Deri më tani, një numër i madh i kompanive të telekomikacionit kanë shprehur interesimin e tyre për të marrë pjesë në këtë proces.



## Qeveria miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë

*Sipas rregullit, aktet nënligjore shërbejnë për të lehtësuar zbatimin e ligjit, por jo për të ndryshuar përmbajtjen e tij.*

Në mbledhjen e 128 të Qeverisë së Kosovës u rishqyrtuar projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-0112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, e cila u miratua në mbledhjen e radhës së Qeverisë, atë të 129. Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë rregullon normat për mallra të ndryshëm, të cilët janë të paraqitur në aneksin e ligjit, siç është kafja, ujërat me përmbajtje të ndryshme, birrat, verërat, duhani, alkooli, vajrat, etj.

Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë lejon ndryshime e normave, përfshirë lirimet nga akciza apo shtimin e listës së mallrave. Kështu në këtë mbledhje u morr vendim që të lirohen nga tatimi i normës së akcizës gazet e naftës dhe hidrokarburet tjera gazoike, të cilat përdoret për qëllime prodhimi. Ndërkaq, të gjithë artikujt tjerë shënuan rritje të akcizës.

Përshkrimi i mallit	Shifra	Tarifa e taksës sipas ligjit për tatimin e normës së akcizës	Tarifat e taksës sipas projektligjit për ndryshimin e ligjit
Kafja e papjekur	0901 110, 0901 1200	0.30 €/kg	/
Kafja e pjekur	0901 2100, 0901 2200	0.60 €/kg	/
Zëvendësimet e kafesë që përmbajnë kafe	0901 9090	1,00 €/kg	/
Ekstraktet, aromat dhe koncentratet e kafesë dhe preparatet me bazë të këtyre ekstrakteve, aromat ose koncentratet ose me bazë të kafesë	2101 30, 2101 12	1,00 €/kg	/
Çikore e pjekur dhe zëvendësimet e tjera të pjekura të kafesë, aromat dhe koncentratet e tyre	2010 30	1,00 €/kg	/
Ujërat, duke përfshirë ujërat minerale dhe të ajrizuara të cilat përmbajnë sheqer të shtuar a ndonjë materie tjetër ëmbëltuese apo që janë me shije, si dhe pijet e tjera joalkoolike, duke mos përfshirë lëngjet e frutave apo të perimeve nga kaptina 2009	2202	0.045 €/L	0.045 €/kg
Birra e prodhuar nga malti	2203	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Verërat nga rrushi i freskët, duke përfshirë verërat me përmbajtje të shtuar të alkoolit; mushti i rrushit, përpos atij nga kaptina 2009	2204	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Vermuti dhe verërat e tjera nga rrushi i freskët me shije të bimëve apo të substancave aromatike	2205	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Pijet e tjera të fermentuara (p.sh. mushti i mollës apo i dardhës, pijet alkoolike nga fermentimi i mjaltës);përzierjet e pijeve të fermentuara e të pijeve joalkoolike të cilat nuk janë cekur ose nuk janë përfshirë diku tjetër	2206	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Etil alkooli i padenatryzuar me përqindje të alkoolit prej 80% apo më të lartë; etil alkooli dhe pijet e tjera alkoolike të denatryzuara të cilësdo përqindje alkoolike	2207	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Etil alkool i padenatryzuar me përqindje të alkoolit prej më pas se 80%, pijet alkoolike, likeret dhe pijet e tjera alkoolike	2208	300 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)	500 €/HI abs.alk. 100% vol në 20oC(l)
Cigaret, cigaret e prera dhe cigarillosët të cilat përmbajnë duhan	2402 1000	1,00 € për një njësi konvencionale (2)	1,00 € për një njësi konvencionale (2)
Cigaret që përmbajnë duhan	2402 20	21,00 € për një njësi konvencionale (2)	25,00 € për një njësi konvencionale (2)
Prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit dhe zëvendësimet e përpunuara të duhanit; duhani i "homogjenizuar" apo i ribërë përmes përpunimit"; ekstraktet dhe esencat e duhanit	2403	21,00 € për një njësi konvencionale (2)	25,00 € për një njësi konvencionale (2)

Përshkrimi i mallit	Shifra	Tarifa e taksës sipas ligjit për tatimin e normës së akcizës	Tarifat e taksës sipas projektligjit për ndryshimin e ligjit
Vajrat dhe prodhimet e tjera të distilimit të katranit të thëngjillit në temperatura të larta; produktet e ngjajshme në të cilët peshë e përbërësve aromatike është më e madhe se përbërësve jo-aromatike	2707	0.275 €/lit	0.325 €/lit
1. Vajrat e petroleumit dhe vajrat e përfituara nga mineralet bituminoze (përpos naftës së papërpunuar); produktet që nuk janë cekur apo përfshirë tjetërkund, të cilat përmbajnë në peshë 70% apo më shumë vajra të petroleumit apo vajra të përfituara nga mineralet bituminoze, ku këto vajra janë përbërësit kryesorë të produktit (përpos vajrave të përdorua) me përjashtim të:	2710 11 dhe 2710 19	0.275 €/lit	0.325 €/lit
(a) Vajra për nxehje (mazuti) nën shifrat 2710 1961 deri 2710 1965 të cilat përdoren nga objektet për nxehje të qarkut për qëllime të nxehjes dhe nga personat e entitetet për qëllime të prodhimitarisë, dhe			
(b) lënda e parë e vajrave tjera lubrifikuese dhe vajra të tjera (brenda shifrës 2710 1999) për prodhimin e vajrave lubrifikues.			
<b>Do të jenë të lira nga tatimi i Akcizës (1).</b>			
<b>2. Tatimi i Akcizës do të jetë për:</b>			
Vajra të gazit	2710 1931 deri 2710 1949	0.31 €/l	0.36 €/lit
Alkooli për motorë, karburantet e llojit të alkoolit për motorët reaktive dhe vajrat e tjera të lehta	27101131 dhe 27101190	0.335 €/l	0.385 €/lit
Hidrokarburet aciklike	2901	0.31 €/lit	0.36 €/lit
Hidrokarburet ciklike	2902	0.31 €/lit	0.36 €/lit
Produktet kundërdetonuese, inhibitorët e oksidimit, inhibitorët e ngjitjes, përmirësuesit e viskozitetit, produktet antikoroze dhe aditivët e tjerë të prodhuar për vajrat minerale (duke përfshirë benzinën) apo për lëngjet e tjera të cilat përdoren për qëllime të njëjta si vajrat minerale	3811	0.31 €/lit	0.36 €/lit
Tretësit kompozit organik dhe holluesit të cilët nuk janë cekur a përfshirë diku tjetër, holluesit e prodhuar të ngjyrës apo të llakut	3814	0.31 €/lit	0.36 €/lit
Alkilbenzenët e përzier dhe alkilnaftalenët e përzier, përpos atyre nga kaptina 2707 apo 2902	3817	0.31 €/lit	0.36 €/lit
Veturat dhe automjetet e tjera motorike parimisht të disenuara për transport të personave (përpos atyre nga kaptina 9802_, duke përfshirë veturat karavak dhe veturat për gara	8703	500 € për çdo automjet	500 € për çdo automjet

## Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

*Pas rishikimit të buxhetit 130 milion euro janë ndarë për autostradën, përderisa nga kufizimet e shpenzimeve janë kursyer 40 milion euro.*

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 është po ashtu në pakon e ligjeve që janë harmonizuar me FMN-në si kusht për të garantuar stabilitetin financiar në Kosovë pas inicimit të projektit infrastrukturor Merdarë-Morinë. Ky projektligj u miratua në mbledhjen e 128-të të Qeverisë, e cila u mbajt më 11 qershor 2010.

Në projektligjin në fjalë, i cili është përputhur me KASH-in, janë vënë dispozita ligjore të cilat kufizojnë ndjeshëm shpenzimet nga ana e organizatave buxhetore dhe është krijuar një disiplinë fiskale në këtë kontekst. Sidoqoftë, kjo dispozitë ligjore për kufizimin e shpenzimeve nuk do të vlejë për agjencitë dhe dikasteret qeveritare të cilat janë themeluar gjatë vitit 2009 dhe 2010, si Ministria e Forcës së Sigurisë, ambasadat, agjencitë e pavarura etj. Në kuadër të këtyre kufizimeve buxhetore organizatat qendrore buxhetore nuk do të mund të rrisin numrin e të punësuarve të përhershëm përtej nivelit të datës 11 qershor 2010 si dhe nuk do të mund t'i rrisin pagat ose shtesat për të punësuarit ekzistues. Kufizime buxhetore do të ketë edhe për shpenzimet kapitale që tejkalojnë totalin e 75% apo më tepër të kufirit për vitin 2011. Gjithashtu, ndarjet për projektin kapital "Autostrada Vërmicë-Merdarë" në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit mund të barten në programin "Shpronësimet për

Autostradën Vërmicë-Merdarë" në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në shumën e cila është e barabartë me atë që është miratuar nga qeveria për shpronësime për këtë projekt. Në total, për këtë projekt madhor janë ndarë, nga rishikimi i buxhetit, 130.7 milionë euro.

Gjithashtu, nga ky rishikim, me ndërhyrjet që janë bërë në kufizimin e shpenzimeve, janë kursyer gjithsejtë 41.5 milionë euro. Është propozuar po ashtu deklarimi i dividendës së PTK-së me 80 milion euro dhe ANP-së me 10 milionë euro, përderisa janë ndarë po ashtu 1.8 milionë euro për prodhimin e pasaportave biometrike, proces ky i cili pritet të fillojë kah fundi i këtij viti. Krahas rishikimit të buxhetit, është paraparë dhe financimi shtesë në paga dhe mëditje në shumën prej 16 milionë euro në rritjen për këtë vit të pagave për policinë, shëndetësinë, rritjen e numrit të pjesëtarëve në forcën e sigurisë, rritjen e pagesave të oficerëve të burgjeve si dhe Ministrinë për Integritet Evropian. Punonjësit e sektorit shëndetësorë, primar dhe sekondar do të mund t'i gëzojnë 30% rritje të pagave të tyre bazë si dhe në të njëjtën kohë është bërë e mundur akomodimi përfundimtar i shtesës prej 44 euro që Qeveria e Kosovës pat premtuar për këta punonjës. RTK do të vazhdojë të jetë e financuar edhe këtë vit me paratë e shtetit në vlerë prej 5.2 milionë euro.

## Miratohet edhe një herë Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011-2013

*Me një muaj vonesë Qeveria miratoi KASH 2011-2013. Sipas saj, eksportet pritet të shënojnë rritje ku nga €649 milionë sa pritet të jetë në vitin 2010, do të arrijnë në €808 në vitin 2013, kurse importet pritet të kenë rritje nga €2.4 miliardë në vitin 2010, në €2.8 miliardë në vitin 2013.*

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë e obligon Qeverinë e Kosovës që para 30 prillit të çdo viti kalendarik t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Një gjë të tillë e kishte bërë Qeveria kur miratoi KASH 2011-2013 në mbledhjen 122, më 30 prill 2010. KASH 2011-2013 u miratua përsëri nga Qeveria e Kosovës më 11 qershor 2010, në mbledhjen e saj të 128-të. Arsytet që shtynë Qeverinë e Kosovës ta miratojë këtë dokument dy herë brenda dy muajve ndryshimet e kërkuara nga FMN në ligjet bazike financiare, të cilat kanë ndikim direkt edhe në KASH 2011-2013.

KASH 2011-2013 përcakton analizat e mjedisit makroekonomik të Kosovës si dhe prezanton një përmbledhje të projektuar që është në dispozicion për financimin e projekteve politike të Qeverisë. Ky dokument paraqet sfidat me të cilat ballafaqohet ekonomia kosovare siç janë niveli shumë i ulët i eksportit në raport me importin, ulja e ndjeshme nga vitet paraprake të investimeve të huaja direkte, ekonomia informale, niveli i lartë i papunësisë, mungesa e hartimit të politikave konkrete që do të bënin të mundur adresimin e këtyre problemeve dhe zgjidhjen e tyre etj. Gjithashtu, në këtë dokument janë paraqitur politikat prioritare të qeverisë të cilat janë: investimet e mëtutjeshme në fushën e transportit, përmirësimi i furnizimit me energji elektrike që duhet të bëhet përmes kryerjes së reformave të nevojshme, privatizimi i distribucionit të KEK-ut si dhe ndërtimi i burimeve të reja të energjetikës, zhvillimin e sektorit të arsimit për t'iu mundësuar të rinjve të marrin aftësitë e nevojshme profesionale për të bërë të mundur inkuadrimin e tyre në treg, ngritjen e funksionalitet të sistemit të gjyqësorit që konsiderohet si katalizator i krijimit të një klime të favorshme për investime dhe rritje ekonomike, reformat fiskale, luftimi i ekonomisë informale përmes projektit të filluar rishtazi nga Qeveria për fiskalizimin e bizneseve, reformimi

i administratës publike, sigurimi i mëtutjeshëm i asistencës financiare nga ana e donatorëve si dhe luftimi i korrupsionit. Sidoqoftë, për shkak të fillimit të implementimit të projektit të ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdarë, shumë nga këto prioritete të Qeverisë pritet të kenë efekte anësore financiare në zbatimin e përgjithshëm të tyre.

Ndryshe, projeksionet makroekonomike sugjerojnë se rritja mesatare reale e BPB për periudhën 2011-2013 pritet të jetë rreth 5.6%. Në vitin 2010, BPB do të jetë 5.1%, ndërsa në vitin 2011 do të ngritet në 6.0%, 5.9% do të jetë në vitin pasues dhe në vitin e fundit, pra në vitin 2013, BPB pritet të jetë rreth 6.2%. Nga treguesit tjerë makroekonomik, konsumi pritet të shënojë rritje nga €4.3 miliardë në vitin 2010, në €5.3 miliardë në vitin 2013. Gjithashtu, investimet pritet të shënojnë rritje prej €1.5 miliardë në vitin 2010 në €2 miliardë në vitin 2013. Eksportet po ashtu pritet të shënojnë rritje ku nga €649 milionë sa pritet të jetë në vitin 2010, do të arrijnë në €808 në vitin 2013. Ndërkaq, edhe importet pritet të kenë rritje nga €2.4 miliardë në vitin 2010, në €2.8 miliardë në vitin 2013.

Sa i përket inflacionit, gjatë periudhës së projektuar kjo shifër do të sillet në rreth 2.3% që konsiderohet stabil nga ekspertët e ekonomisë. Krahasuar me vitin 2009, të hyrat e përgjithshme janë projektuar të rriten në 18% deri në vitin 2013. Nga €1.1 miliardë sa pritet të jenë të hyrat e përgjithshme në vitin 2010, ato pritet të arrijnë shumën prej €1.3 në vitin 2013. Shpenzimet e përgjithshme pritet po ashtu të rriten nga €1.2 miliardë në vitin 2010 në €1.5 miliardë në vitin 2013. Pra me rritjen e shpenzimeve në raport me të hyrat, Kosova pritet të realizojë deficit buxhetor nga viti 2010 deri në vitin 2013. Deficiti buxhetor për vitin 2010 pritet të jetë rreth €144 milionë, pastaj në vitin 2011 deficiti pritet të rritet në €310 milionë, pastaj në vitin 2012 pritet të shënojë ulje në €244 milionë dhe në vitin 2013 pritet të jetë €188 milionë.



## Miratohet PVPE 2010

Në mbledhjen e 128-të të Qeverisë së Kosovës është miratuar Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2010 (PVPE 2010). Përderisa PVPE-të e viteve të kaluar kanë pasur një numër të madh të objektivave dhe aktiviteteve për të përmbushur, ky PVPE përmban një numër më të vogël aktivitesh, është i fokusuar më ato objektiva që janë më përmbajtësore dhe që bëjnë dallim real në rrugën e përmbushjes së standardeve të kërkuara. PVPE 2008 identifikonte 1502 veprime, PVPE 2009 identifikonte 1598 veprime, kurse PVPE 2010 përmban 1000 veprime. Ashtu siç thuhet edhe në hyrje të PVPE 2010, ulja e aktiviteteve (veprimeve) nuk është bërë vetëm në zvogëlimin

sasior të aktiviteteve, por edhe për ngritjen e cilësisë së këtij dokumenti. Nga 1598 veprimet e parapara në PVPE 2009 janë zgjidhur vetëm 30% të tyre.

Më 24 qershor 2009, GAP ka publikuar analizën “Kriteret Ekonomike të Kopenhagës – çfarë duhet të bëj Kosova?” (këtë analizë mund ta lexoni këtu: <http://institutigap.org/?cid=1,5,116>), në të cilën kemi paraqitur si problem mos zbatimin e PVPE 2008 dhe numrin e madh të sfidave që ajo identifikon. Analiza e GAP kërkonte që hartuesit e PVPE të përqendroheshin në më pak veprime, përmbushja e të cilave do të bënte dallimin real sa i përket përmbushjes së standardeve evropiane, ashtu siç

është vepruar tani më me PVPE-në 2010.

Partneriteti Evropian është një nga instrumentet e BE-së për të mbështetur reformat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Partneriteti Evropian publikohet një herë në dy vjet. Deri më tash, BE ka publikuar tri raporte të Partneritetit Evropian për Kosovën. Në bazë të Partneritetit Evropian, Qeveria e Kosovës për herë të katërt ka miratuar edhe Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (pas atyre të 2006, 2008 dhe 2009), me të cilin synohet që të zgjidhen sfidat e identifikuara në Partneritetin Evropian për Kosovën.

## Kosova me Strategji të Sigurisë

Pas themelimit të strukturave shtetërore të sigurisë, siç janë Ministria e Forcës së Sigurisë, Forca e Sigurisë së Kosovës, Komisioni Parlamentar për Siguri, Këshilli i Sigurisë, etj., Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 129-të më 15 qershor ka miratuar edhe Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, e para strategji në këtë fushë në Kosovë. Kjo strategji është përgatitur nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Sipas Ligjit për Themelimin e Këshillit të Sigurisë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, përgatitë dhe shqyrton Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Strategjia e Sigurisë së Kosovës miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar. Këshilli i Sigurisë është përgjegjës edhe për koordinimin e veprimeve në mes institucioneve të sigurisë dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së Sigurisë.

Në këtë strategji edhe një herë konfirmohet vullneti i Republikës së Kosovës për tu anëtarësuar në mekanizmat ndërkombëtar politik, ekonomik dhe të sigurisë, bashkëpunimi rajonal, kontributi në bazë të kapaciteteve në paqen rajonale dhe ndërkombëtare, etj. Theks i veçantë është vendosur në nevojën për bashkëpunim më të madh në mes të vetë institucioneve të Kosovës. Si sfida për sigurinë kjo strategji identifikon: korrupsionin, krimi dhe krimi i organizuar, terrorizmi, armët e paligjshme dhe mjetet shpërthyes, katastrofat dhe emergjencat civile, mjetet shpërthyes, ekonomia jo e zhvilluar, papunësia dhe varfëria, etj.

Strategjia e Sigurisë i është dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim, dhe kjo e fundit pritet që të marr vendim gjatë muajit korrik.

## Strategjia Legjislative 2010 tani përmban 128 projektligje

*Në gjashtë mujorin e parë të 2010, janë miratuar 34 projektligje apo 27% e Strategjisë Legjislative 2010.*

Qeveria e Kosovës sërish ka ndryshuar përmbajtjen e Strategjisë Legjislative 2010. Këtë e ka bërë me dy vendime të ndryshme brenda muajit Qershor. Me vendimin 04/127, Qeveria e Kosovës listës prej 126 projektligjeve të Strategjisë Legjislative 2010 (SL'10) i ka shtuar edhe tri projektligje të reja; kurse me vendimin 02/129 nga SL'10 është larguar Projektligji për Nënshkrim Elektronik.

Projektligjet që i janë shtuar SL'10 janë: Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2010; dhe Projektligji për Ndryshimin dhe

Plotësimin e Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Të tri këto projektligje janë miratuar dhjetë ditë më vonë, në mbledhjen e 128-të të Qeverisë së Kosovës. Futja e këtyre projektligjeve në SL'10 dhe miratimi i tyre i shpejtë kanë ardhur si rezultat i marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Pas këtyre ndryshimeve të bëra në SL'10, tani kjo strategji përmban 128 projektligje. Në gjashtë mujorin e parë të 2010, janë miratuar 34 projektligje apo 27% të SL'10.

## Qeveria pronëson pronat publike dhe shpronëson pronat private për hir të autostradës

Me nisjen e ndërtimit të autostradës më 25 prill 2010 nga konzorciumi Bectel&Enka, Qeveria ka vazhduar të merret me pjesën e saj të facilitimit të këtij procesi përmes shpronësimit të trasesë Vërmicë-Merdarë. Në mbledhjen e 126-të, të mbajtur më 1 qershor 2010, Qeveria e Kosovës morri vendim që të gjitha pronat publike të paluajtshme brenda korridorit, trasesë së autostradës, të barten në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Veprimet e Qeverisë rreth këtij projekti datojnë që nga 7 marsi 2008, gjegjësisht vendimi i Qeverisë nr. 13/10, me të cilin i kërkohet Kuvendit të Kosovës që të shpall zonë të interesit të veçantë ekonomik trasenë kah do të kalojë autostrada Vërmicë-Merdare, kërkesë të cilën Kuvendi i Kosovës e kaloi në seancën plenare të 2 qershorit të po atij viti. Pas këtij akti, pëson vendimi tjetër i Qeverisë, i datës 10 prill 2008 me të cilin krijohet Komisioni që do të përgatisë ofertën e shprehjes së interesit për këtë projekt. Më 27 mars 2009, Qeveria e Kosovës merr vendim për fillimin e shpronësimit të pronave të paluajtshme për nevoja të ndërtimit të këtij projekti madhor, përkatësisht në segmentin Vërmicë-Prizren (Vendimi nr. 3/59). Më 2 shtator të po të njëjtit vit, Qeveria miraton rekomandimet e Komitetit

Ndërministror dhe kompanisë konsulente “Eversheds” në partneritet me “American Global Consulting” në lidhje me ndërtimin e autostradës në fjalë (Vendimi Nr. 4/80). Kurse më 8 tetor 2009, Qeveria miraton kërkesën për shpronësimin e pjesës së ngastrave kadastrale të pronave të paluajtshme për 13 zona kadastrale të segmentit Vërmicë-Prizren (Vendimi Nr. 2/86). Ndërkohë, lind një propozim i ri nga Komiteti Ndërministror që traseja e autostradës të ndërtohet nga “Qafa e Dulës” në Suharekë ku parashihej të ndërtohet një tunel në komunën e Malishevës. Kjo për shkak të kostos së lartë që kishte traseja e hartuar paraprakisht. Në fund, pëson Vendimi Nr. 02/105 me të cilin Qeveria e autorizon Komitetin ndërministror që të fillojë negociatat me kompaninë “Bechtel&Enka Joint Venture” për nënshkrimin e kontratës.

Kurse në mbledhjen e saj të 128 Qeveria e Kosovës ka marrë vendim përfundimtar për shpronësimin e tokave private në komunën e Prizrenit nga do të kalojë autostrada Vërmicë-Merdare. Qeveria ka miratuar shpronësimin e tokave të paluajtshme private në segmentin Vërmicë – Novakë që përfshinë këto 13 zona kadastrale: Vërmicë, Zhur, Poslisht, Vlashnje, Prizren,

Atmagjë, Dushanovë, Trepeticë, Petrova Sellë, Caprac, Shpenadi, Velezhë dhe Novakë. Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, MEF dhe MTPPT, së bashku me Komunën e Prizrenit, brenda pesë ditë pune do të duhej t'i dërgojnë vendimin personave të identifikuar në listën e përpiluar për shpronësim. Në këtë listë janë identifikuar emrat e 977 pronarëve, numri i parcelës, lloji i pronës, sipërfaqja totale e asaj prone, sipërfaqja e shpronësuar nga Qeveria dhe sipërfaqja e mbetur tek pronari. Në mesin e pronave të shpronësuar janë edhe 15 shtëpi. Brenda dhjetë ditësh, këto ministri e kanë për obligim të bëjnë këtë vendim publik edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazhin më të madh në Kosovë. Si pjesë e këtij vendimi është akti i vlerësimit ku është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit. Shuma e pronës së shpronësuar do të paguhet plotësisht nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Ndërkaq, subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 ditëve në gjykatën kompetente, por vetëm për shumën e kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



## Qeveria shkel Rregulloren për Ligjin Themelor të Punës

*Edhe pse me ligj nuk lejohet që punonjësit të punojnë me orar të shtesë më të gjatë se 20 orë në javë, ose 40 orë në muaj; 410 punonjës të MPB për katër muaj do të punojnë me orar shtesë prej 23 orësh në javë dhe 98 orë në muaj. Kurse punonjësit e kontraktuar nga “Bechtel&Enka” orarin e tyre do të definojnë në marrëveshje me punëdhënësin.*

Marrëdhënia e punës edhe më tutje mbete e parregulluar me ligj të Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, kjo fushë edhe më tutje mbulohet nga Rregullorja e UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës. Implementimi i kësaj rregulloreje ka qenë dhe vazhdon të jetë problem, sidomos sa i përket respektimit të orarit të punës, kontratës, largimit të punonjësve në procedura jo të rregullta, etj. Shpeshherë kësaj i kanë kontribuar edhe vetë institucionet publike. Edhe këtë vit, ashtu sikurse edhe dy vitet e mëparshme, 410 punonjësit e Agjencionit për Regjistrim Civil do të punojnë me orar të zgatur. Në mbledhjen e 127 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin 05/127 është miratuar plani i MPB “Diaspora 2010”. Me këtë zgjatet orari ditor i punës për punonjësit e Agjencionit për Regjistrim Civil, nga 8 orë në 11 orë në ditë, si dhe

8 orë pune të shtunave. Ky orar do të zgjas për katër muaj, duke filluar nga 1 qershori deri më 30 shtator. Këta punonjës për punën e tyre jashtë orarit do të paguhen me nga 200 Euro shtesë në muaj. Buxheti i paraparë për programin “Diaspora 2010” është 238.000 Euro. Mirëpo, puna jashtë orarit për këta punonjës është më e gjatë se sa që lejohet me ligjet në fuqi. Me nenin 16.14 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 thuhet se “Puna jashtë orarit nuk mund të zgjasë më shumë se 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj”. Kurse orari i zgatur për punonjësit e MPB tejkalon këtë kufizim ligjor. Puna jashtë orarit për 410 punonjësit e MPB do të arrij në 23 orë në javë, ose 98 orë në muaj.

Kjo nuk është shkella e vetme që është bërë në dëm të punonjësve. Po në të njëjtën mbledhje, me

vendimin 06/127, Qeveria e Kosovës aprovon kërkesën e kompanisë “Bechtel&Enka” për zgjatjen e orarit javor të punës për punëtorët e angazhuar përkohësisht në ndërtimin e autostradës Morinë-Prishtinë-Merdare. Sipas këtij vendimi, zgjatja e orarit të punës lihet që të bëhet në pajtim në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, gjithnjë duke pasur parasysh se autostrada është një projekt i rëndësisë nacionale. Qeveria e Kosovës, përmes këtij vendimi ekzekutiv, suspendon rregullat për orarin e punë të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës do të vlej deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës së Kosovës.

## Qeveria miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Në mbledhjen e 128 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është miratuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Përderisa Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) sipas ligjit në fuqi kishte pavarësi të pjesshme, ajo tani disponon pavarësi të plotë, ku ngjashëm janë shtuar edhe kompetencat e drejtorit të përgjithshëm. Neni 7 i projektligjit i jep kompetenca të pakufizuara drejtorit, sado që të jetë e nevojshme, për administratë tatimore efikase. Në të kaluarën përzgjedhja e drejtorit është bërë nga Ministri i MEF dhe është aprovuar nga qeveria, kurse tani Kryeministri i Kosovë gëzon autoritet në përzgjedhje si dhe shkarkim, me apo pa propozim të ministrit.

Një ndër ndryshimet më të mëdha të ligjit është pajisja me numër fiskal dhe certifikatë fiskale, e përcaktuar në nenin 11, e cila në ligjin e mëparshme parashihej përmes marrjes së numrit identifikues të tatimpaguesit. Ky nen thotë se çdo person i cili i nënshtrohet ndonjë lloji tatimi të administruar nga ATK duhet të

pajisjet me numër fiskal, përderisa procedurat dhe kriteret që duhet ndjekur do të rregullohen me një akt nënligjor të lëshuar nga MEF. Me numër fiskal mund të pajisen edhe personat jo-rezident por që veprojnë në Kosovë, ndërsa neni parasheh edhe refuzimin e numrit fiskal për çdo entitet i cili ka një histori të mos-përmbushjes së përgjegjëseve tatimore në të kaluarën. Risi në projektligj është edhe çregjistrimi i tatimpaguesve, ku çdo tatimpagues gëzon të drejtën e çregjistrimit, përderisa i ka përmbushur të gjitha detyrimet tatimore, ndërsa ATK duhet t'i bëjë të gjitha analizat dhe të dal me një përgjigje brenda 60 ditësh. Ndëshkimi për mos përdorim të Pajisjeve Elektronike Fiskale, që njëherazi nënkupton mos-regjistrim të transaksioneve, është 1.000 euro, përderisa lidhur me certifikatën fiskale është shtuar edhe neni mbi ndëshkimin administrativ, e që kap shumën prej 500 euro. Nenet e ndëshkimeve janë ndryshuar dukshëm, kështu ndëshkimet lidhur me deklarimin e tatimit dhe mbi deklarimin e rimbursimeve tatimore janë zvogëluar. Përderisa ligji në fuqi parashihte ndëshkim 100% për ndryshimin

e shumës korrekte të tatimit ajo tani është 25%.

Ky projektligji parasheh edhe krijimin e njësisë për hetime tatimore, gjegjësisht hetimin e veprave penale, zbatimin e kodit të procedurës penale, ndjekjen dhe kohëzgjatjen e veprave penale dhe pjesëmarrjen e ATK-së në procedurat gjyqësore, nene këto të cilat i mungojnë ligjit në fuqi. Për më shumë, ATK mund të përcaktojë specifikimin për llojet e mallrave elektronike për regjistrat që bëhen në forma elektronike, nen ky i cili gjithashtu mungonte në ligjin mbi administratën tatimore dhe procedurat.

Pjesa tjetër e projektligjit është rreth plotësimit të ligjit, siç është regjistrimi i mallrave dhe stoqeve, posedimi i dokumentacionit mbi origjinën e mallrave, vlerësimin e drejtorit, kufizimet kohore, vlerësimet në rast rreziku, njoftimi i vlerësimeve, nenet mbi anulimin e dokumenteve tatimore gjatë shkeljeve të legjislacionit tatimor, mbi detyrimet në rastet e veprës penale në fushën e tatimeve, mbi detyrimet e personave përgjegjës, si dhe mbi vlerësimin e detyrimit të personit të tretë.

## Miratohet projektligji për mbrojtjen e konkurrencës

*Sipas Raportit vjetor të Komisionit Kosovar të Konkurrencës (KKK) për 2009, ky agjencion në vitin e parë të funksionimit të tij ka arrit që të shfuqizojë dy marrëveshje që bien ndesh me parimet e konkurrencës së lirë: marrëveshja e furrtarëve për çmimin e bukës dhe marrëveshja e kompanive të sigurimit për POOL-in kufitar.*

Më 23 qershor 2010, në mbledhjen e 131-të të Qeverisë është miratuar Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Vendimi 03/131). Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe pas miratimit të tij në Qeveri, ky projektligj do t'i dërgohet edhe Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është pjesë e Strategjisë Legjislative 2010 dhe është miratuar në afatin e paraparë me këtë strategji. Që nga viti 2004 është në fuqi Ligji i Kuvendit të Kosovës Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës. Edhe pse ligji aktual parasheh krijimin e Komisionit Kosovar të Konkurrencës, si institucion që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, KKK është themeluar tek më 7 nëntor 2008 me vendim të Kuvendit të Kosovës. Por KKK ka filluar punën vetëm në mars 2009.

Por Projektligji i ri që është miratuar në Qeveri do të zëvendësojë në tërësi këtë ligj. Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ndalon të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marra në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që: caktojnë çmimet, ndajnë tregjet, etj. Abuzimi i pozitës

dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar. Janë të ndaluara përqendrimet e ndërmarrjeve që mund të dëmtojnë ndjeshëm konkurrencën, veçanërisht në qoftë se një përqendrim i tillë ka si pasojë forcimin e pozitës dominuese ekzistuese ose krijimin e një pozitë të re dominuese. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji është përgjegjësi e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK). AKK është institucion i pavarur dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Kosovës. Ky autoritet ka të drejtën që të shpërndaj gjoba për ndërmarrjet që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

Respektimi i rregullave të ekonomisë së tregtisë së lirë është ende sfidë për ekonominë kosovare. Shumë biznese në Kosovë arrijnë marrëveshje të fshehta sa i përket vendosjes së çmimeve. Të tilla raste aplikohen tek kompanitë e sigurimit, furrtarët, etj. Sipas Raportit Vjetor të Punës për 2009 të paraqitur në Kuvendin e Kosovës nga Komisioni i Konkurrencës, KKK gjatë vitit 2009 ka hetuar dhe ka kërkuar anulimin e marrëveshjeve kundërligjore të furrtarëve të Kosovës që çmimi i bukës të jetë 30 cent; si dhe ka shfuqizuar marrëveshjen e kompanive të sigurimit të nënshkruar që më 2003 për POOL-in kufitar.



## Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

Kritikat e njëpasnjëshme të organizatave financiare ndërkombëtare e sidomos asaj të FMN-së karshi autoriteteve publike në çështjet e menaxhimit të financave publike kanë shtyrë Qeverinë që në pakon e ndryshimit dhe plotësimit të një sërë ligjesh tjera të fus dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ky vendim u morr në mbledhjen e 128-të të Qeverisë të mbajtur më 11 qershor 2010. Projektligji në fjalë ka pësuar ndryshime sa i përket procedurave të shpenzimit të parave publike nga organizatat buxhetore, përkatësisht marrja parasysh e të hyrave apo ulja e shpenzimeve

nga organizatat buxhetore në procesin e hartimit të buxhetit të tyre, pra e tëra kjo për të ruajtur stabilitetin ekonomiko-fiskal. Në nenin 25 e cila ka të bëjë me Ligjet e rishqyrtuara të ndarjeve buxhetore dhe buxheteve i është shtuar edhe një pikë ku thuhet se çdo propozim ndryshim në Ligjin për Ndarjet Buxhetore ose në buxhetin e Kosovës nuk do të rezultojë në ndonjë rritje të shpenzimeve për vitin fiskal që së paku nuk barazohet me reduktimin e shpenzimeve dhe/ose masat për rritjen e të ardhurave. Me fjalë të tjera, në hartimin e buxheteve do të kihen parasysh të hyrat dhe në bazë të të hyrave do të përcaktohen

edhe shpenzimet apo nëse nuk mund të rriten të hyrat atëherë duhet të zvogëlohen shpenzimet. Një nen tjetër substancial është Neni 19 ku flitet për miratimin dhe hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Në këtë nen thuhet që deri më 30 prill të secilit vit kalendarik, Qeveria duhet t'ia dorëzojë Kuvendit këtë dokument për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale. Kjo çështje në ligjin e vjetër nuk ka qenë mjaft mirë e rregulluar pasi që përpos për vitin 2009, procedurat dhe afatet kohore për miratimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve nuk kanë qenë të specifikuar siç duhet.



## Qeveria miraton Strategjinë për Pronësi Intelektuale

Pronësia Intelektuale i referohet krijimeve mendore: shpikjeve, veprave letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve, etj. Titullarët e këtyre të drejtave mund t'i ndalojnë të tjerët që t'i përdorin krijimet e tyre pa autorizim paraprak. Pronësia intelektuale këtu përfshinë 'pronësinë industriale' dhe 'të drejtën e autorit'. Me vendimin nr. 10/128, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Pronësi Intelektuale dhe Planin e Veprimit 2010 – 2014. Një vendim i tillë u morr në mbledhjen e rregullt të Qeverisë më 11 qershor 2010. Kjo strategji synon që të shërbejë si dokument politikë që siguron baraspeshën në mes të interesave të krijuesve dhe interesit publik duke parandaluar çfarëdolloj abuzimi me të drejtat që rrjedhin nga prona intelektuale të cilat do të pengonin ekonominë e tregut dhe konkurrencën e ndershme. Objektiv i kësaj Strategjie është përmirësimi i klimës investuese dhe stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, duke mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale. Implementimi efektiv i kësaj strategjie kërkon edhe një sistem efikas gjyqësor që siguron mbrojtjen e të drejtave intelektuale. Rol me rëndësi luajnë edhe doganat e Kosovës, sidomos Njësitë për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, i krijuar në kuadër të doganave të Kosovës më 1.2.2009. Megjithatë, ky njësit ka vetëm dy zyrtarë që nuk mjaftojnë për

një zbatim efektiv të kësaj strategjie. Ndërkaq, inspektorët e tregut duhet t'i kontrollojnë rregullisht vendet e tregtimit, prodhimit, depot, vendet e punës dhe gjithandej ku produktet vihen në shërbim. Një ndër sfidat e mëdha që parasheh kjo Strategji është heqja nga tregu i Kosovës i mallrave piraterike siç janë CD-të, DVD-të dhe softuerët e ndryshëm. Kjo kërkon edhe vetëdijesimin e qytetarëve të Kosovës për luftimin e kësaj dukurie. Kurse themelimi i Zyrës për të Drejtat Autoriale pranë MKRS është hap tjetër tejet i domosdoshëm që duhet të ndërmerret.

Plani i Veprimit për implementimin e strategjisë për Pronësi Intelektuale 2010-2014 përfshinë këto hapa:

- Konsolidimi i mëtutjeshëm i kornizës ligjore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane
- Ngritja e kapaciteteve teknike të autoriteteve administrative të DPI-së
- Ngritja teknike e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit
- Themelimi i organizatave për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta, dhe zhvillimi i një grupi të agjentëve për pronësi intelektuale
- Ngritja e vetëdijes dhe edukimit për pronësi intelektuale



## Miratohet Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

Në mbledhjen e 127-të, të mbajtur me 1 qershor 2010, Qeveria miratoi Programin Kombëtar të Shkencës së Republikës së Kosovës. Ky Program bazohet në Ligjin 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, i miratuar nga Kuvendi më 27 shtator 2004, ku sipas nenit 52 të këtij ligji Qeveria e Kosovës duhet ta hartojë këtë Program dhe më pas t'ia dërgojë Kuvendit për miratim. Për miratimin e këtij Programi Qeverisë i janë dashur gati gjashtë vite. Programi Kombëtar i Shkencës do të synojë, ndër të tjera, të ndihmojë në identifikimin e prioriteteve shkencore, të krijojë kushte për investime infrastrukturore, të forcojë pjesëmarrjen në projektet ndërkombëtare kërkimore-shkencore dhe të përpunojë një program sistematik arsimor për hulumtues.

Në përmbledhjen e këtij Programi vlerësohet se kërkimi dhe zhvillimi teknologjik është ende një ndërmarrje marginale në Kosovë. Mungojnë edhe kërkimi bazik dhe statistikat teknologjike. Ende nuk ekziston një sistem funksional dhe i qëllimshëm i risimitarisë (inovacionit). Arsyet kryesore për këtë mangësi ishin përjashtimi i imponuar i komunitetit akademik dhe të kërkimit shkencor në periudhën e para-luftës, kur personeli akademik i tanishëm ishte i izoluar nga zhvillimet ndërkombëtare shkencore;

shkatërrimet materiale dhe jo materiale gjatë luftës; dhe, më pas, një proces i vështirë i rimëkëmbjes ekonomike. Deri vonë, shpenzimet e përgjithshme për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim në Kosovë ishin vetëm rreth 0.1% të BPV-së. Prandaj, ky Program ka për qëllim të neutralizojë këto deficite duke ofruar një kornizë konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë. Si prioritete kryesore u identifikuan: burimet natyrore, energjia dhe mjedisi; prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit; kërkimet shkencore në mjekësi; studimet shoqërore dhe ekonomike; studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Këshilli Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës do të përbëhet nga: Akademik Rexhep Ismajli (kryetar) Dr. Dukagjin Pupovci (sekretar) dhe nga këta anëtarë: Dr. Avdyl Krasniqi, Dr. Fetah Podvorica, Dr. Isuf Krasniqi, Dr. Jahja Drançolli, Dr. Husnija Bibuljica, Dr. Nexhmi Rexha, Dr. Radivoje Mancic, Akademik Rexhep Ferri, Dr. Skender Kaçiu, Dr. Suzana Kërliu, Dr. Xhevat Perjuci, Dr. Zejnullah Gruda dhe Dr. Zejnullah Rrahmani. Programi Kombëtar i Shkencës pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës për një periudhë pesëvjeçare, i cili, gjithashtu, duhet të sigurojë fonde për realizimin e programit të propozuar nga Qeveria.



## Themelohet Këshilli Ndërmintor për Politika Tregtare

*Ky Këshill do të drejtojë politikat tregtare të Kosovës për rritjen e eksportit dhe uljen e importit.*

Me 1 qershor 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim për themelimin e Këshillit Ndërmintor për Politika Tregtare. Në përbërje të Këshillit janë 7 ministra të Qeverisë: ministrat e MTPT, MBPZHR, MEF, MIE, MAP, MPJ dhe MTI. Ministri i MTI njëherazi edhe do të udhëheq këtë këshill. Ky Këshill ka për qëllim t'i drejtojë politikat tregtare të Republikës së Kosovës në lidhje me tregtinë ndërkombëtare. Dokumenti i Politikave Tregtare të Kosovës, i miratuar vitin e kaluar, nuk parasheh formulimin e këshillit ndërmintor, por, ai parasheh formimin e dy grupeve koordinuese për realizimin e procesit të politikës tregtare. Grupi i parë duhet të formohet brenda MTI-së, ndërsa i dyti duhet të fus nën një ombrellë edhe aktorët tjerë relevant (ministritë, komunitetin e biznesit, donatorët dhe aktorë tjerë) që do të ndihmonin në koordinimin e aktiviteteve për të kompletuar këtë proces).

Hartimi i këtij dokumenti ka ardhur si nevojë për të adresuar sfidat e bilancit negativ tregtar, i cili mbetet ende barrë e rëndë për ekonominë e Republikës së Kosovës. Dokumenti i Politikave Tregtare të Kosovës është dokument gjithëpërfshirës, i cili

propozon masa specifike të cilat synojnë ngritjen e kapaciteteve konkurruese (brenda dhe jashtë Kosovës), rritjen e eksportit dhe njëherazi uljen e importit. Grupi i parë që do të formohet ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve konkurse në tregun e brendshëm, përderisa grupi i dytë i politikave do të punojë në masat për lehtësimin e tregtisë së jashtme, përmirësimin e burokracisë në kufi dhe zvogëlimin e kostove të transaksioneve që shfaqen në momentin e kalimit të kufirit. Ky dokument parasheh edhe formimin e një grupi të tretë (më të vogël) i cili në mënyrë specifike do të merret me promovimin e eksportit.

Dokumentu 'Politika Tregtare e Kosovës' në mënyrë të detajuar shpjegon pengesat që has Kosova në liberalizimin e tregut dhe hapat që duhet ndërmarrë për t'i tejkaluar ato. Në bazë të kësaj janë hartuar politikat afatshkurta, afatmesme dhe afatgjate, për krijimin e një tregu të qëndrueshëm dhe konkurrues në spektrin ndërkombëtar si dhe zbatimi i strukturës konceptuese të politikës zhvillimore gjatë negociatave për marrëveshjet ndërkombëtare, siç janë OBT-ja, CEFTA dhe ato të BE-së.

## Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës

*Ky ligj themelon Zyrën e Protokollit të Shtetit, në kuadër të Ministrisë së Punëve të jashtme, e cila ka për detyrë organizimin dhe realizimin e të gjitha angazhimeve protokollare të Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme. Protokollin e Shtetit përfaqëson përmbledhjen institucionale të kritereve që rregullojnë çdo aspekt të marrëdhënieve zyrtare, kompetencat dhe obligimet e të cilin janë përcaktuar në dispozitat ligjore.*

Në mbledhjen e 130 të datës 16 qershor 2010, Qeveria mori vendim të miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës. Sikurse gjatë miratimit të ligjit në vitin 2009, edhe tani procedimi i këtij projektligji në Kuvend ka zgjatur mbi 1 muaj pas aprovimit në mbledhjen e Qeverisë.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, parasheh një nen shtesë pas ceremonialit diplomatik, i cili flet për akreditimin e shefit të misionit diplomatik. Ky ligj gjithashtu përmban nene shtesë mbi takimet zyrtare të shefit të misionit, fillimin e detyrës së diplomatit, atashet ushtarak, konsullit dhe funksionalit të organizatave ndërkombëtare.

Ligji për protokollin e shtetit të republikës së Kosovës është plotësuar edhe me paragrafë shtesë në nenet e ligjit. Kështu, neni 8 të ligjit mbi hapjen e një përfaqësie të re diplomatike i është shtuar paragrafi ku thuhet se diplomati duhet të jetë i pajisur me një

letër nga MPJ i shtetit përkatës drejtuar MPJ-së së Kosovës, në të cilin duhet të shënohet misioni i ngarkuar. Gjithashtu është plotësuar neni mbi presidentin, e cila obligon Qeverinë të miraton një akt ligjor mbi kriteret e fotografisë së Presidentit; përderisa tek neni për zonjën e parë thuhet se ajo e shoqëron Presidentin në udhëtimet shtetërore jashtë vendit, duke i dhënë asaj lirin të marrë pjesë në punët dhe takimet zyrtare të Presidentit. Janë plotësuar edhe nenet mbi pritjen në presidencë dhe përdorimin e sallës për personat e rëndësishëm të veçantë të aeroportit.

Ndryshimi dhe plotësim ka pësuar edhe neni 41 i ligjit mbi radhën e përparësive të rangjeve zyrtare, të cilin janë të ndarë në 3 grupe. Grupi i parë përbehet prej: Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe ish-presidentëve. Grupi i dytë, njëherazi edhe grupi me më së shumti anëtarë ka pësuar ndryshime më të mëdha, ku i janë shtuar edhe 10 anëtar të rinj, përderisa grupi i tretë i ka 5 anëtar më shumë.

## Miratohet Projektligji për Ujërat e Kosovës

Në mbledhjen e 128-të, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin 7/128, miratoi Projektligjin për Ujërat e Kosovës. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik të Republikës së Kosovës; të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore; të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tejsHFrytëzimi dhe keqpërdorimi; të përcaktojë kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore. Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, erozionin; objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohen ose shkarkohen ujërat.

Sipas Nenit 2 të këtij projektligji, në pajtim me qëllimet për mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë, administrimi me ujëra bazohet në: konceptin ekologjik, social dhe ekonomik, parimin e përkujdesjes, parimin e parandalimit, parimin e minimizimit të përdorimit të resurseve ujore, parimin e integritit, parimin „ndotësi paguan”, parimin „shfrytëzuesi paguan”, parimin e pengimit të ndotjes; parimin e perspektivës kohore; parimin e pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në informata; parimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara; parimin universal të shërbimeve ujore.

Neni 12, paraqet Kompetencat dhe Përgjegjësitë të cilat i përkasin Ministrisë e cila bënë hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me të gjitha çështjet e ujërave në Republikën e Kosovës dhe bënë implementimin e tyre, bënë zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave, si dhe objektivave nga programi i Qeverisë për fushën e ujërave dhe mjedisit. Gjithashtu edhe komuna ka kompetencat e veta e cila është përgjegjëse për lëshimin e lejeve ujore të përcaktuar sipas aktit nënligjor për leje ujore.

Ndërsa, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve për administrim të resurseve ujore, harmonizimit dhe bashkërenditjes së nevojave dhe interesave të ndryshme për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e përhershëm të statusit të ujërave në territorin e Republikës së Kosovës themelohet Këshilli Ndërmintor. Ky Këshill përbëhet nga 7 anëtarë të cilët zgjidhen nga ministrit e linjës - Qeveria e Kosovës. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Ndërmintor të Ujërave, zgjedhen për një periudhë kohore prej tre vitesh me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Sigurimi i burimeve financiare për administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e ujërave bëhet nga: pagesa për shfrytëzimin e ujërave; pagesa për shkarkimin e ujërave; pagesa për nxjerrjen e materialeve inerte; buxheti i Kosovës; komunat; donacionet dhe grantet; dhe burimet tjera financiare, në pajtim me Ligjin. Sa i përket buxhetit, sipas Nenit 92 të këtij Ligji, mjetet për administrim, menaxhim dhe zhvillim të resurseve ujore parashihen me Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe komunave. Këto mjete shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve dhe masave të parapara me dokumentet e planeve dhe programeve, të nxjerrura në pajtim me këtë Ligj.

## Miratohet Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të 131-të, miratoi Projektligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Ky projektligj synon që përmes vlerësimit strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve. Me këtë ligj përcaktohen kushtet, mënyra dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, përmes integritit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) nënkupton përgatitjen e një raporti të VSM, mbajtjen e konsultimeve, marrjen parasysht të këtij raporti dhe të rezultateve të konsultimeve në vendimmarrje si dhe ofrimin e informacioneve lidhur me vendimin në pajtim me këtë Ligj. Bazuar në Nenin 3 të këtij Projektligji, vlerësimi strategjik i mjedisit bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i

tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis. Hartimi i raportit për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit, etj., të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Sipas nenit 17, mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, e kryen Ministria. Ndërsa monitorimi i zbatimit të këtij ligji duhet të kryhet nga inspektorati i Ministrisë, në përputhje me ligjin. Raportin mbi zbatimin e këtij ligji e përgatit Ministria tri vite pas hyrjes në fuqi të tij, ndërsa në periudhën vijuese çdo pesë vite.

## Qeveria miraton Strategjinë për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë

Në përputhje me Planin e Punës së Qeverisë, gjegjësisht të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 131-t të saj, të datës 23 qershor 2010, miratoi strategjinë 2010-2014 për zhvillimin e infrastrukturës së metrologjisë në Kosovë. Qeveria e Kosovës beson se me vendosjen e drejtë të kriteve dhe standardeve teknike për produkte dhe shërbime, legjislacionin e harmonizuar me atë të BE-së dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e tyre, ajo po krijon një ambient konkurrues në tregun vendor dhe atë të jashtëm. Mirëpo, sukcesi i reformave të nisura varet edhe nga funksionimi adekuat i sistemit metrologjik në Kosovë. Miratimi i kësaj strategjie do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të sigurojë funksionim të suksesshëm të këtij sektori dhe përputhjen e standardeve vendore me ato ndërkombëtare. Infrastruktura metrologjike është parakusht për

zbatimin e shumë direktivave të BE-së dhe më tepër së 20 mijë standardeve teknike të BE-së për Kosovën. Në Kosovë ekziston Ligji për metrologjinë (matjeve) i cili rregullon sistemin e metrologjisë, duke përfshirë atë shkencore, industriale dhe ligjore. Përgjegjësia për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit kombëtar të metrologjisë është përgjegjësi e Departamentit të Metrologjisë së Kosovës (DMK) që funksionin si pjesë e MTI-së. Me anë të kësaj strategjie synohet të drejtohet DMK në ndërtimin e infrastrukturës metrologjike – sistemin shtetëror të matjeve standarde si bazë për të siguruar rezultate të matshme dhe të besueshme në fushat e interesit publik.

Strategjia përmban principet themelore, zbatimin e të cilave nënkupton zhvillimin e duhur të infrastrukturës metrologjike. Këto principe përfshijnë:

- Përshtatjen dhe krahasimin me standardet ndërkombëtare – me qëllim që standardet kosovare t'i përafrohen atyre të BE-së;
- Funksionimi i vetë-qëndrueshëm afatgjatë – me qëllim që të menaxhohen drejtë aspektet financiare dhe aspektet e tjera për të krijuar funksionim stabil;
- Roli i DMK – ku DMK do të ketë rolin menaxhues në hartimin e sistemit shtetëror të metrologjisë. Për më tepër funksionimi dhe zhvillimi i DMK-së do t'i përshtatet nevojave dhe prioriteteve të Kosovës;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve shtetërore – gjatë zhvillimit të sistemit metrologjik do të merren për bazë institucionet që përmbushin kërkesat për cilësinë e shërbimeve të ofruara;
- Cilësia e shërbimeve – cilësia e shërbimeve metrologjike është bazë për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, prandaj dhe vlerësimi i palës së tretë nga trupi akreditues do të jetë i nevojshëm në të gjitha rastet;
- Niveli teknik i infrastrukturës metrologjike – fillimisht do të jetë më i ulët, për shkak të mungesës së përvojës adekuate, prandaj zbatimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe akreditimi i kapaciteteve të matjes fillimisht është i rëndësishë së lartë, e cila do të zhvillohet me kohë me përfitimin e përvojës në këtë fushë;
- Përdorimi i infrastrukturës metrologjike – për shkak të investimeve të nevojshme të mëdha në hapësira, në pajisje dhe kuadër teknik, është e rëndësishme të përdoret çdo pjesë e infrastrukturës metrologjike në Kosovë që është nën përgjegjësi të institucioneve kosovare;
- Anëtarësimi në organizatat kyçe ndërkombëtare – është i rëndësishë kyçe për zhvillimin e suksesshëm të metrologjisë në të ardhmen, por fillimisht do të bëhet vlerësimi i përfitimeve dhe kostos së anëtarësimit.

Strategjia në mënyrë të detajuar shpjegon gjendjen aktuale, identifikimin e problemeve dhe hapat që duhen ndërmarrë për sistemin metrologjike të Kosovës dhe të standardeve kombëtare të matjes. Strategjia gjithashtu shpjegon zhvillimin e metrologjisë ligjore, industriale, shkencore dhe përshtatjen në fushat dhe sektorët e tjerë të ndërlidhura me këtë sektor. Kjo strategji është shumë e rëndësishme, meqë përfshinë periudhën më të vështirë të zhvillimit të sistemit të metrologjisë në Kosovë, përdërisa fazat e mëvonshme do të kenë investime më të vogla – kryesisht në mirëmbajtjen e sistemit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në baza vjetore buxheti i dhe stafi i departamentit të metrologjisë në Kosovë:

Viti	Totali i buxhetit të DMK-së (EUR)	Numri i stafit aktual	Stafi i ri	Totali i stafit
2010	631,272.68	12	-	12
2011	625,000.36	12	6	18
2012	625,128.00	18	-	18
2013	625,128.00	18	-	18
2014	625,128.00	18	-	18
<b>2010 - 2014</b>	<b>3,131,657.04</b>	<b>12-18</b>	<b>6</b>	<b>18</b>

Burimet financiare të paraqitura në tabelë do t'i mundësojnë DMK-së themelimin e laboratorëve të nevojshme për matje në fushat e masës, vëllimit dhe rrjedhjes, matjeve elektrike, temperaturës dhe lagështisë, gjatësisë, kohës, shtypjes, forcës, etj. Buxheti prej 3.131.657,04 është barrë për buxhetin e Kosovës, megjithatë DMK-ja është e përkushtuar për të gjetur financim nga donatorët.

## Qeveria ndan mjete financiare për fshatin Debëllde, për Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës dhe për gjurmimin e një varreze masive

Me tri vendime të ndryshme, në mbledhjen e saj të 128-të, Qeveria ka ndarë mjete financiare për tri projekte të ndryshme. Me vendimin nr. 11/128, Qeveria ka vendosur të ndajë mjete financiare prej 530.000 euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga mosshfrytëzimi i tokës për periudhën 2001-2009 në fshatin Debëllde të Komunës së Vitisë. Ky vendim është marrë pas raportit të Komisionit Ndërmintor për vlerësimin e dëmeve në pronat e pronarëve të këtij fshati. Megjithatë për fazën e parë është vendosur të ndahen vetëm 200.000 euro, kurse kuvendi komunal i Vitisë duhet të themelojë një komision i cili do të bëjë kompensimin e dëmeve për secilin pronar. Komisioni ndërmintor për vlerësimin e dëmeve në këtë fshat ishte themeluar nga Qeveria më 23 tetor 2009. Problemi me fshatin Debëllde daton që nga viti 2001 kur pas një marrëveshjeje politike në mes të ish republikës Jugosllave dhe Republikës së Maqedonisë, një pjesë e territorit të Kosovës iu dha kësaj të fundit, duke iu pamundësuar fshatarëve të këtij fshati kufitar të punojnë tokat e tyre. Ky kontest u përmbyll më 16 tetor 2009 kur qeveritë e dy vendeve, Kosovës dhe Maqedonisë, nënshkruan marrëveshjeje për demarkacionin e kufirit, me ç'rast u dakordua që një pjesë e pronave të fshatit

Debëllde të kalojë në territorin e Maqedonisë. Kjo marrëveshjeje, siç kemi shkruar edhe në GAP Monitor 9&10 hasi në kundërshtime të mëdha të opinionit kosovar.

Me vendimin nr. 12/128, Qeveria ka marrë vendim që të aprovojë kërkesën e Lidhjes së Shkrimtarëve për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 6.000 euro për financimin e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Drini Poetik'. Ky festival është i pari i llojit të tij, i paraparë të mbahet në Prizren më 10-11 qershor. Këto mjete do të ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe do të bartën në xhirollogarinë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Ndërkaq, me vendimi i tretë për ndarjen e mjeteve financiare ka bëjë me gjurmimin e një varreze masive. Në këtë mbledhje Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar kërkesën e Departamentit për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore për ndarjen e 50 mijë euro, për të gjurmuar në një lokacion të identifikuar ku dyshohet për një varrezë masive me rreth 20 trupa. Këto mjete pritet të transferohen nga buxheti i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur në kodin buxhetor të departamentit të lartpërmendur.

## Ndahen 250.000 euro për invalidët e luftës së UÇK-së për rehabilitimin në bregdetin shqiptar

Ashtu sikurse në vitin e kaluar, edhe këtë vit Qeveria e Kosovës i ka ndarë mjete Shoqatës së Invalidëve të UÇK-së dhe Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së. Mjetet e ndara me vendimin 05/131 kapin shumën 250.000 euro dhe do të shërbejnë për rehabilitimin e invalidëve të luftës së UÇK-së në bregdetin shqiptar. 200 mijë euro i ndahen Shoqatës së Invalidëve të UÇK për rehabilitimin e 800 invalidëve dhe 200 veteranëve të UÇK, kurse 50 mijë euro i ndahen Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së për rehabilitimin e 250 prindërve të dëshmorëve.

Edhe vitin e kaluar, Qeveria e Kosovës kishte ndarë 200 mijë euro për këtë qëllim, me ç'rast në bregdetin shqiptar ishin dërguar 1000 invalidë dhe veteranë të UÇK.

## Qeveria ndanë 300.000 euro për ri-integrimin e personave të riatdhesuar

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin 06/131, ndau mjete financiare në vlerë prej 300.000 euro për fondin inicial për zbatimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në pajtim me vendimin e Qeverisë Nr. 4/126 të datës 26 maj 2010. Siç e kemi cekur edhe në vendimin Nr. 4/126 të muajit maj, ri-integrimi i personave të riatdhesuar vjen si rrjedhojë e procesit të riatdhesimit dhe si i tillë paraqet një nga sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova gjatë periudhës së pas luftës. Sipas statistikave zyrtare rreth 5000 persona kanë qenë të riatdhesuar me forcë brenda një viti. Përgjegjësia për ri-integrimin e personave të riatdhesuar ka qenë deri vonë e UNMIK-ut, UNHCR-së, IOM-it dhe organizatave tjera që kanë shqyrtuar këto raste. Sidoqoftë, në vitin 2006 kjo përgjegjësi iu është transferuar institucioneve kosovare, respektivisht Bordit Ekzekutiv i cili menaxhon implementimin

e Strategjisë dhe Planit Veprues për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Po ashtu vlen të ritheksohet se procesi i ri-pranimit dhe i ri-integrimit paraqet një pjesë të padiskutueshme që ndikon në procesin e liberalizimit të vizave, dhe i cila po ashtu në bashkëpunim me Komisionin Evropian është rekomanduar që procesi i ripranimit dhe riatdhesimit të adresohet. Veç kësaj, me adresimin e këtyre çështjeve do të zvogëlohet nevoja për emigrim ilegal e cila do ndikojë në hapjen e rrugës për emigrimin legal duke përfshirë emigrimin qarkullues. Mjetet e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara dhe barten në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

## Sigurohet hapësira për ndërtim të 'Shkollës së Talenteve' dhe kampusit të AUK

Me financim të Bankës Botërore do të ndërtohen shkolla fillore dhe e mesme për nxënësit me aftësi të larta; kurse në Hajvali, Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK) do të ndërtojë kampusin e tij. Qeveria e Kosovës, pas kërkesës së Komunës së Prishtinës, ka marrë vendim që tu sigurohet hapësira e nevojshme për ndërtimin e këtyre objekteve shkollore.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 130-të, më 16 qershor, ka miratuar kërkesën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës që të shpallet zonë e interesit të veçantë sipërfaqja prej 90736 m<sup>2</sup>, te vendi i quajtur "Lama e Druve". Kjo hapësirë është afër Tjegullores së Prishtinës dhe është në pronësi të "INM Kosova". Më 26 shtator 2008, Kuvendi Komunal i Prishtinës kishte marrë vendim që t'i kërkohej mbështetje Qeverisë së Kosovës që këtë

zonë ta shpallë zonë të veçantë. Në këtë hapësirë, Banka Botërore ka shprehur gatishmërinë që të financojë së paku dy shkolla, të niveli fillor dhe të mesëm, për nxënësit me aftësi të larta, apo siç është emërtuar "Shkolla e Talenteve".

Po në të njëjtën mbledhje të Qeverisë është marrë vendim që të shqyrtohet kërkesa e Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK) për ndërtimin e një kampusi të ri në Hajvali. Ngastrat kadastrale ku planifikohet të shtrihet kampusi i AUK janë në pronësi të AKP, dhe për këtë qëllim nevojitet shqyrtim i mëtejshëm.



## Përmbledhje

Më poshtë kemi radhitur të gjitha vendimet e marra nga Qeveria gjatë muajit qershor 2010 (mbledhjet 127-131):

### **Vendimet nga mbledhja e 127-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 1 qershor 2010:**

1. Vendimi 01/127, të gjithë pronat publike të paluajtshme brenda korridorit, trasesë së autostradës Vërmicë-Merdarë bartën në pronësi të Qeverisë së Kosovës;
2. Vendimi 02/127, miratohet Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës;
3. Vendimi 03/127, themelohet Këshilli Ndërmintor për Politika Tregtare;
4. Vendimi 04/127, plotësohet Strategjia Legjislative e vitit 2010 e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
5. Vendimi 05/127, miratohet plani i Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e orarit ditor të punës në 11 orë dhe aplikimi i orarit 8 orësh të punës të shtunave në Agjencionin e Regjistrimit Civil, me qëllim të realizimit të programit 'Diaspora 2010';
6. Vendimi 06/127, miratohet kërkesa e kompanisë 'Bektel-Enka' nr. 115, e datës 21.05.2010, lidhur me zgjatjen e orarit javor të punës për punëtorët e angazhuar përkohësisht në ndërtimin e autostradës Morinë-Prishtinë-Merdare.

### **Vendimet nga mbledhja e 128-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 11 qershor 2010:**

1. Vendimi 2/128, miratohet Plani i Veprimit për Partneritet Evropian për vitin 2010;
2. Vendimi 3/128, miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011-2013;
3. Vendimi 4/128, miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48, për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
4. Vendimi 5/128, miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
5. Vendimi 6/128, miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;
6. Vendimi 7/128, miratohet Projektligji për Ujërat e Kosovës;
7. Vendimi 8/128, miratohet për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
8. Vendimi 9/128, miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme private në ngastrat kadastrale të paraqitura në tabelat e më poshtme të cilat janë pjesë e këtij vendimi të Autostradës Vërmicë – Merdare, segmenti Vërmicë – Novakë, komuna e Prizrenit, përkatësisht zonat kadastrale Vërmicë, Zhur, Poslisht, Vlashnje, Prizren, Atmaxhë, Dushanovë, Trepeticë, Petrova Sellë, Caprac, Shpenadi, Velezhë dhe Novakë;
9. Vendimi 10/128, Miratohet Strategjia për Pronësi Intelektuale dhe Plani i Veprimit 2010-2014;
10. Vendimi 11/128, ndahen mjete financiare në vlerë prej 530.000 euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga mosshfrytëzimi i tokës për periudhën 2001-2009, në fshatin Debëllde, Komuna e Vitisë;
11. Vendimi 12/128, aprovohet kërkesa e Lidhjes së Shkrimtarëve për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 6.000 euro për financimin e festivalit ndërkombëtar të poezisë 'Drini Poetik';
12. Vendimi 13/128, aprovohet kërkesa e departamentit për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore në Ministrinë e Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 50.000 euro.

**Vendimet nga mbledhja e 129-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 15 qershor 2010:**

1. Vendimi 01/129, miratohet Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës;
2. Vendimi 02/129, për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative për vitin 2010 Nga Strategjia Legjislative për vitin 2010 shlyhet Projektligji për nënshkrim elektronik;
3. Vendimi 03/129, miratohet projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-0112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

**Vendimet nga mbledhja e 130-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 16 qershor 2010:**

1. Vendimi 01/130, të ofrohet për tenderim dhe shitje 75% e aksioneve të Ndërmarrjes Publike PTK, SH. A.;
2. Vendimi 02/130, miratohet, me ndryshime, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës;
3. Vendimi 03/130, sipas kërkesës së kryetarit të Komunës së Prishtinës shpallet Zonë e Veçantë ngastra kadastrale 3114-1 deri 3125 -2, me sipërfaqe të tërësishme prej 90736 m<sup>2</sup>, te vendi i quajtur 'Lama e Druve' dhe e cila është në pronësi të INM Kosova;
4. Vendimi 04/130, miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme, konkretisht parcelave nr. 257, 259, 260, 261 dhe 382 nën administrimin e AKP-së, të cilat ndodhën në zonën kadastrale të Hajvalisë dhe preken nga kampusi i Universitetit Amerikan në Kosovë.

**Vendimet nga mbledhja e 131-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 23 qershor 2010:**

1. Vendimi 02/131, miratohet Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
2. Vendimi 03/131, miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës;
3. Vendimi 04/131, miratohet Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë në Kosovë 2010 – 2014;
4. Vendimi 05/131, miratohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 250.000 eurove për rehabilitim në bregdetin shqiptar;
5. Vendimi 06/131, ndahen mjete financiare në vlerë prej 300.000 euro për fondin inicial për zbatimin e Strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në pajtim me Vendimin e Qeverisë nr.4/126 të datës 26 maj 2010.

# gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
+381 38 224 145  
monitor@insitutigap.org  
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



**Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.**

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund te gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet [www.gapmonitor.org](http://www.gapmonitor.org)

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.